VENDIM
Nr. 247, datë 30.4.2025

PËR PROCEDURAT, KUSHTET, KRITERET, AFATET, VLEFSHMËRINË DHE FORMATET PËR DHËNIEN, SHFUQIZIMIN DHE PEZULLIMIN E LICENCAVE DHE AUTORIZIMEVE PËR PRODHIMIN, IMPORTIMIN, EKSPORTIMIN, TRANSITIMIN E LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të pikës 1, të nenit 22, të ligjit nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
KUSHTET DHE KRITERET E POSAÇME TË LICENCIMIT DHE AUTORIZIMIT

Neni 1
Kushtet dhe kriteret e posaçme të licencimit për import ose eksport të lëndëve plasëse për përdorim civil

1. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (në vijim "AKSHE") është institucioni përgjegjës që lëshon licencat e importit, eksportit dhe të prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, si dhe autorizimet për importin, eksportin, transitin e lëndëve plasëse për përdorim civil për operatorët ekonomikë kërkues.

2. Operatori ekonomik, që kërkon të pajiset me licencë importi ose eksporti të lëndëve plasëse për përdorim civil, duhet të plotësojë kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

a) Të ketë në objektin e aktivitetit veprimtarinë e importit/eksportit të lëndëve plasëse për përdorim civil;

b) Të ketë të instaluar dhe të jenë funksionale sistemet aktive për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin për ambientet e magazinimit, në përputhje me parashikimet e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (në vijim "MZSH"), të miratuar nga strukturat përkatëse të shërbimit të MZSH-së;

c) Të ketë në ruajtje fizike ambientet e magazinimit të lëndëve plasëse për përdorim civil me një shoqëri të licencuar për shërbimin privat të sigurisë fizike;

ç) Të ketë drejtues teknik, i cili është përgjegjës për çështjet e sigurimit teknik, trajnimit të personelit me rregullat e sigurimit teknik. Drejtuesi teknik duhet të jetë i pajisur me "Dëshmi zjarrmëtari", lëshuar nga organi përgjegjës në ministrinë që mbulon çështjet e industrisë dhe të energjetikës;

d) Të këtë miratuar projektin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin nga strukturat e shërbimit të MZSH-së për mjediset ku do të magazinohet dhe do të prodhohet lënda plasëse;

dh) Administratori dhe punonjësit e angazhuar duhet të gëzojnë besueshmëri për ushtrimin e aktivitetit me lëndët plasëse, e cila vërtetohet nga dokumenti i besueshmërisë që përpilohet nga struktura e Policisë së Shtetit, ku shtetasi ka vendbanimin, në bazë të kërkesës së bërë nga AKSHE-ja;

e) Administratori dhe punonjësit e angazhuar të operatorit ekonomik nuk duhet të jenë të dënuar për vepra penale;

ë) Operatori ekonomik të mos ketë detyrime apo gjoba të pashlyera, të cilat janë marrë në zbatim të nenit 31, të ligjit nr. 74/2021, të vendosura nga AKSHE-ja.

Neni 2

Kushtet dhe kriteret e posaçme të licencimit për prodhimin e lëndëve plasëse për përdorim civil

Operatori ekonomik, që kërkon të pajiset me licencë për prodhimin e lëndës plasëse për përdorim civil, duhet të plotësojë kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

a) Të ketë në objektin e aktivitetit veprimtarinë e prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil;

b) T'i jetë nënshtruar procedurës për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe të jetë i pajisur me vendim për vlerësimin e ndikimit në mjedis/deklaratë mjedisore, që në fazën e projektidesë, si dhe të sigurojë lejet përkatëse mjedisore për prodhimin lëndëve plasëse përpara vënies në punë të instalimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit;

c) Të këtë në pronësi ose përdorim objektin ku do të ushtrojë veprimtarinë e prodhimit dhe të magazinimit të lëndëve plasëse;

ç) Të përcaktojë projektin teknologjik të prodhimit, i cili duhet të jetë i miratuar nga një inxhinier projektues i licencuar dhe me eksperiencë në projektimin e linjave teknologjike;

d) Të ketë të hartuar dhe të miratuar projektin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin për mjediset ku do të magazinohet dhe do të prodhohet lënda plasëse, ku të jenë përcaktuar sistemet e shuarjes nga zjarri, si brenda edhe jashtë ambienteve të prodhimit dhe magazinimit;

dh) Të ketë të instaluara dhe funksionale sistemet për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin për ambientet e prodhimit dhe magazinimit;

e) Të ketë në ruajtje fizike ambientet e prodhimit e të magazinimit me një shoqëri të licencuar për shërbimin privat të sigurisë fizike;

ë) Punonjësit e angazhuar për nevojat e operatorit ekonomik të plotësojnë kushtet e aftësimit shëndetësor dhe trajnimit, sipas kërkesave të nenit 13, të ligjit nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil";

f) Administratori dhe punonjësit e angazhuar duhet të gëzojnë besueshmëri për ushtrimin e aktivitetit me lëndët plasëse, e cila vërtetohet nga dokumenti i besueshmërisë që përpilohet nga struktura e Policisë së Shtetit, ku shtetasi ka vendbanimin në bazë të kërkesës së bërë nga AKSHE-ja;

g) Administratori dhe punonjësit e angazhuar të operatorit ekonomik nuk duhet të jenë të dënuar për vepra penale;

gj) Për produktet, të cilat kërkon të prodhojë, duhet të kryejë pranë një organizmi evropian të notifikuar procedurat e vlerësimit të përputhshmërisë të lëndëve plasëse, duke ndjekur njërën nga procedurat e parashikuara në nenin 16, të ligjit nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil";

h) Të ketë të punësuar drejtues teknik me kohë të plotë pune dhe të jetë i regjistruar, sipas ekstraktit të QKB-së, i cili:

i. të ketë arsimin e lartë të nivelit "Master i shkencave" apo ekuivalent me të në inxhinieri kimie/kimi industriale/inxhinieri mekanike ose të ketë përfunduar arsimin e lartë të nivelit "Master i shkencave" apo ekuivalent me të në fusha akademike ushtarake, me profil kimi, armatim, municion, forca xheniere, lëndë plasëse ose lëndë piroteknike;

ii. të ketë përvojë pune dyvjeçare në fushën e prodhimit të lëndëve plasëse ose të jetë trajnuar e certifikuar pranë një subjekti prodhues për lëndë plasëse brenda ose jashtë vendit;

iii. të vërtetojë me raport mjekësor që është i aftë nga ana mendore e fizike;

iv. të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë nga organet përgjegjëse të Policisë së Shtetit;

v. të mos jetë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë;

vi. të jetë i pajisur me certifikatë trajnimi për kryerjen e kursit të trajnimit për zjarrfikës me rrezik të lartë pranë Akademisë së Sigurisë, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin.

i) Të ketë të miratuar rregulloren e sigurimit teknik, të hartuar nga drejtuesi teknik, ku përcaktohen kushtet e sigurisë e shëndetit të punonjësve dhe mjedisit gjatë prodhimit, magazinimit, asgjësimit dhe testimit të lëndëve plasëse, si dhe identifikimin e rreziqeve, kompensimin e rrezikut nga zjarri, menaxhimin e emergjencave, me qëllim zbutjen e rrezikut të mbetur, nëpërmjet organizimit dhe menaxhimit të ekipeve të sigurisë në drejtim të masave parandaluese dhe mbrojtëse, me referencë të veçantë ndaj sjelljes së zjarrit të strukturave (REI);

j) Të mos punësojë punonjës të patrajnuar nga drejtuesi teknik lidhur me sigurinë në punë, të cilëve u matet efektiviteti i trajnimeve nëpërmjet testimeve para marrjes në punë dhe monitorimeve periodike gjatë periudhës së marrëdhënieve të punës;

k) Personeli përgjegjës për magazinimin, asgjësimin dhe testimin e lëndëve plasëse duhet të jetë i pajisur me dëshminë e zjarrmëtarit nga organi përgjegjës në ministrinë, që mbulon çështjet e industrisë dhe të energjetikës;

l) Operatori ekonomik të mos ketë detyrime apo gjoba të pashlyera, të cilat janë marrë në zbatim të nenit 31, të ligjit nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil", të vendosura nga AKSHE-ja.

Neni 3

Kushtet dhe kriteret e posaçme për pajisjen me autorizim për import ose eksport të lëndëve plasëse për përdorim civil

Operatori ekonomik, që kërkon të pajiset me autorizim për import ose eksport të lëndëve plasëse për përdorim civil, duhet të plotësojë kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

a) Të jetë i pajisur me licencën përkatëse për import ose eksport të lëndëve plasëse;

b) Për lëndët plasëse, që kërkon të importojë ose të eksportojë, duhet të ketë certifikatat e vlerësimit të përputhshmërisë të lëndëve plasëse, duke ndjekur njërën nga procedurat e parashikuara në nenin 16, të ligjit nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil";

c) Të ketë nënshkruar një kontratë ose urdhërporosi;

ç) Të jetë i pajisur me autorizim për magazinim të lëndëve plasëse, lëshuar nga struktura përgjegjëse në Policinë e Shtetit;

d) Të ketë të përcaktuara mjetet e transportit për kryerjen e importit/eksportit, të cilat duhet të jenë të pajisura me certifikatën "ADR", të lëshuar sipas legjislacionit në fuqi për transportin e lëndëve të rrezikshme;

dh) Të mos ketë detyrime apo gjoba të pashlyera, të cilat janë marrë në zbatim të nenit 31, të ligjit nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil", të vendosura nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

Neni 4

Kushtet dhe kriteret e posaçme të licencimit për pajisjen me autorizim për transitin e lëndëve plasëse për përdorim civil

Operatori ekonomik, që kërkon të pajiset me autorizim për transitin e lëndëve plasëse për përdorim civil, duhet të plotësojë kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

a) Të ketë një kontratë të vlefshme për shërbimin e transportit me shoqërinë transportuese ose të dhënat e transportuesit;

b) Për mallin që kërkon të transitojë duhet të ketë leje eksporti nga vendi eksportues dhe licencat ose lejet e importit nga vendi importues. Në rast se këto dokumente nuk lëshohen në vendet e huaja, operatori ekonomik që kërkon autorizim transiti, duhet të bëjë një vetëdeklarim, ku të përcaktojë subjektet eksportuese dhe importuese, si dhe përdoruesin e fundit të lëndëve plasëse;

c) Të ketë të përcaktuara mjetet e transportit, periudhën kohore të transitit, itinerarin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, pikën doganore hyrëse dhe pikën doganore dalëse;

ç) Të mos ketë detyrime apo gjoba të pashlyera, të cilat janë marrë në zbatim të nenit 31, të ligjit nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil", të vendosura nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror i Eksporteve.

KREU II
DOKUMENTET SHOQËRUESE QË PARAQITEN PËR PAJISJEN ME LICENCË APO AUTORIZIM DHE FORMATET PËR DHËNIEN E LICENCAVE

Neni 5
Dokumentet shoqëruese për pajisjen me licencë për import ose eksport të lëndëve plasëse për përdorim civil

Kërkesa për pajisje me licencë për import ose eksport të lëndëve plasëse për përdorim civil duhet të paraqitet nëpërmjet portalit *"e-Albania"*. Dokumentacioni i nevojshëm, në funksion të kësaj kërkese, përbëhet nga:

a) Dokumentacioni, që do të merret nga vetë institucioni për subjektin aplikues nëpërmjet ndërveprimit, i cili është:

i. vërtetimi që shoqëria dhe administratori nuk janë në proces gjyqësor penal, lëshuar nga gjykata e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kompetente në territorin ku ka selinë;

ii. vërtetimi nga prokuroria kompetente që shoqëria, administratori dhe punonjësit e angazhuar të operatorit ekonomik nuk janë në procedim penal;

iii. vërtetimi nga shërbimi përmbarimor që personi juridik nuk ka detyrime ndaj personave fizikë apo juridikë, privatë ose shtetërorë;

iv. gjendja për shlyerjen e detyrimeve nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve;

v. autorizimi për magazinimin e lëndëve plasëse, ku të jetë përcaktuar specifikisht kapaciteti mbajtës për lëndë plasëse, lëshuar nga strukturat përgjegjëse në Policinë e Shtetit.

b) dokumentacioni, që do të dorëzohet nga vetë subjekti aplikues nëpërmjet portalit *"e-Albania",* i cili është:

i. dokumentacioni tekniko-ligjor për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin (projektin e miratuar për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin), si dhe certifikata e sigurisë nga zjarri për ambientet e magazinimit, lëshuar nga strukturat e shërbimit të MZSH-së;

ii. kontrata e shërbimit për ruajtjen fizike të ambienteve të magazinimit të lëndëve plasëse me një person juridik, të licencuar për shërbimin privat të sigurisë fizike, ku të jenë të parashikuara rregullat e ruajtjes e të sigurimit të magazinave dhe objekteve të tjera të aktivitetit;

iii. kontrata me drejtuesit teknikë, përgjegjës për çështjet e sigurimit teknik, trajnimit të personelit me rregullat e sigurimit teknik. Drejtuesi teknik duhet të jetë i pajisur me "Dëshmi zjarrmëtari", lëshuar nga institucioni përgjegjës për industrinë minerare;

iv. vetëdeklarimi për punonjësit e angazhuar për nevojat e operatorit ekonomik, që plotësojnë kushtet e aftësimit shëndetësor, trajnimit sipas kërkesave të nenit 13, të ligjit nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil";

v. vërtetimi i besueshmërisë për administratorin dhe punonjësit e angazhuar;

vi. vetëdeklarimi i administratorit dhe punonjësve të angazhuar, me anë të cilit japin aprovimin për verifikimin në regjistrin e gjendjes gjyqësore. Certifikata e gjendjes gjyqësore për administratorin dhe punonjësit e angazhuar, të cilët nuk duhet të jenë të dënuar për vepra penale, nxirret nga administrata e AKSHE-së.

Neni 6

Dokumentet shoqëruese për pajisjen me licencë për prodhimin e lëndëve plasëse për përdorim civil

1. Kërkesa për pajisje me licencë për prodhimin e lëndës plasëse për përdorim civil paraqitet nëpërmjet portalit *"e-Albania"*. Dokumentacioni i nevojshëm, në funksion të kësaj kërkese, përbëhet nga:

a) dokumentacioni, që do të merret nga vetë institucioni për subjektin aplikues nëpërmjet ndërveprimit, i cili është:

i. vërtetimi nga prokuroria e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kompetente në territorin ku kanë selinë, që shoqëria dhe administratori, nuk janë në procedim penal;

ii. vërtetimi që shoqëria dhe administratori nuk janë në proces gjyqësor penal, lëshuar nga gjykata e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kompetente në territorin ku ka selinë;

iii. vërtetimi nga Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror që shoqëria dhe administratori nuk kanë detyrime ndaj personave fizikë apo juridikë, privatë ose shtetërorë;

iv. vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, ku subjekti ka selinë;

v. vendimi për vlerësimin e ndikimit në mjedis, deklarata mjedisore dhe leja përkatëse mjedisore për prodhimin e lëndëve plasëse;

vi. leja e ndërtimit të objektit për prodhimin e lëndëve plasëse;

vii. certifikata e Sigurisë nga Zjarri (CSZ), si dhe projekti i miratuar për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin nga strukturat e shërbimit të MZSH-së për mjediset ku do të magazinohet dhe do të prodhohet lënda plasëse;

viii. certifikata e trajnimit për drejtuesin teknik për kryerjen e kursit të trajnimit "për aktivitete me rrezik të lartë zjarri" pranë Akademisë së Sigurisë, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin ose nga qendra të tjera të certifikuara për sigurinë nga zjarri;

ix. autorizimi për magazinimin e lëndëve plasëse, lëshuar nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë.

b) dokumentacioni, që do të dorëzohet nga vetë subjekti aplikues nëpërmjet portalit *"e-Albania",* i cili është:

i. plani i veprimit, si dhe dokumentacioni për kushtet e sigurisë në punë, trajnimin e punonjësve dhe stafit, miratuar nga drejtuesi teknik;

ii. projekti i ndërtimit për prodhimin e lëndëve plasëse, si dhe dokumentacioni i pronësisë ose kontrata e përdorimit të ambienteve që do të përdorë për prodhim;

iii. kontrata për ruajtjen e ambienteve të prodhimit e të magazinimit me një shoqëri të licencuar për shërbimin privat të sigurisë fizike, ku të jenë parashikuar rregullat e ruajtjes e të sigurimit të objektit për magazinimin e lëndëve plasëse;

iv. dokumentacioni teknik për pajisjet testuese, si dhe pajisjet laboratorike për provat kimike;

v. vetëdeklarimi për punonjësit e angazhuar për nevojat e operatorit ekonomik, që plotësojnë kushtet e aftësimit shëndetësor, trajnimit, sipas kërkesave të nenit 13, të ligjit nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil";

vi. vërtetimi i besueshmërisë për administratorin dhe punonjësit e angazhuar;

vii. kontrata e punësimit me drejtuesin teknik, ku të jenë të përcaktuara detyrat e drejtuesit teknik, në lidhje me sigurinë në punë dhe sigurimin e prodhimit;

viii. certifikatat e vlerësimit të përputhshmërisë të lëndëve plasëse, duke ndjekur njërën nga procedurat e parashikuara në nenin 16, të ligjit nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil";

ix. rregullorja e sigurimit teknik, ku përcaktohen kushtet e sigurisë e shëndetit të punonjësve dhe mjedisit gjatë prodhimit, magazinimit, asgjësimit dhe testimit të produkteve piroteknike, si dhe identifikimi i rreziqeve, kompensimi i rrezikut nga zjarri, menaxhimi i emergjencave, me qëllim zbutjen e rrezikut të mbetur, nëpërmjet organizimit dhe menaxhimit të ekipeve të sigurisë në drejtim të masave parandaluese dhe mbrojtëse, me referencë të veçantë ndaj sjelljes së zjarrit të strukturave (REI);

x. projekti teknologjik i prodhimit, i miratuar nga një inxhinier projektues, i licencuar, dhe me eksperiencë në punë të ngjashme ose në projektimin e linjave teknologjike ose nga një institucion projektimi vendas ose i huaj;

xi. vetëdeklarimi i administratorit dhe punonjësve të angazhuar, me anë të cilit jepet aprovimi për verifikimin në regjistrin e gjendjes gjyqësore. Certifikata e gjendjes gjyqësore për administratorin dhe punonjësit e angazhuar, të cilët nuk duhet të jenë të dënuar për vepra penale, nxirret nga administrata e AKSHE-së.

2. Dokumentacioni për individët, personat fizikë dhe juridikë, i cili do të sigurohet nga AKSHE-ja nëpërmjet ndërveprimit institucional, do të konsiderohet i vlefshëm dhe origjinal në dosjen e aplikimit.

3. Pas plotësimit të kushteve dhe kritereve të licencimit të prodhimit dhe plotësimit të dokumentacionit, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, me qëllim kryerjen e procedurave të vlerësimit të përputhshmërisë, merr vendim për të lejuar prodhimin vetëm për nevoja testimi, deri në pajisjen nga një organizëm evropian, i notifikuar me certifikatat e vlerësimit të përputhshmërisë, sipas përcaktimeve të nenit 16, të ligjit nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil".

Neni 7

Dokumentet shoqëruese për pajisjen me autorizim për import ose eksport

Operatori ekonomik, që kërkon të pajiset me autorizim për import ose eksport të lëndëve plasëse, duhet të paraqesë nëpërmjet portalit *"e-Albania",* dokumentet e mëposhtme:

a) Dokumentacionin e origjinës së mallit me llojet dhe sasitë e lëndëve plasëse nga fabrika prodhuese, si dhe faturën e mallit të shoqëruar me listën e paketimit;

b) Dokumentacionin me të dhënat teknike të përbërjes së lëndëve plasëse, emërtimin e tyre, kodin përkatës të shoqëruara me fotografi;

c) Deklaratën e përputhshmërisë lëshuar nga prodhuesi, si dhe dokumentacionin për përmbushjen e procedurave për vlerësimin e përputhshmërisë së lëndëve plasëse, duke paraqitur një nga modulet e parashikuara në nenin 16, të ligjit nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse";

ç) Kopjen e kontratës së shërbimit të transportit me shoqërinë transportuese, nëse ka, ose të dhënat e transportuesit;

d) Kopjen e kontratës me një shoqëri të pajisur me licencë të ruajtjes së sigurisë fizike për shoqërimin e transportit të mallrave nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë;

dh) Kopjen e kontratës ose urdhërporosisë me subjektin e huaj;

e) Në rastet e autorizimit për eksport, deklaratën e përdoruesit të fundit nga subjekti i huaj importues;

ë) Deklaratën për gjendjen e magazinës për sasinë e lëndëve plasëse që disponon.

Neni 8

Dokumentet shoqëruese për pajisjen me autorizim për transitin e lëndëve plasëse

Operatori ekonomik, që kërkon të pajiset me autorizim për transitin e lëndëve plasëse për përdorim civil, duhet të paraqesë nëpërmjet portalit *"e-Albania"* dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentacionin e origjinës së mallit me llojet dhe sasitë e lëndëve plasëse nga fabrika prodhuese, si dhe faturën e mallit të shoqëruar me listën e paketimit;

b) Dokumentacionin me të dhënat teknike të përbërjes së lëndëve plasëse;

c) Kopjen e kontratës së shërbimit të transportit me shoqërinë transportuese, nëse ka, ose të dhënat e transportuesit;

ç) Kopjen e kontratës me një shoqëri të pajisur me licencë të ruajtjes së sigurisë fizike për shoqërimin e transportit të mallrave nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë;

d) Licencat ose lejet e eksportit nga vendi eksportues dhe/ose licencat ose lejet e importit nga vendi importues. Në rast se këto dokumente nuk lëshohen në vendet e huaja, operatori ekonomik që kërkon autorizim transiti duhet të bëjë një vetëdeklarim, ku të përcaktojë subjektet eksportuese dhe importuese, si dhe përdoruesin e fundit të lëndëve plasëse;

dh) Të dhëna për mjetet e transportit, periudhën kohore të transitit, itinerarin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, pikën doganore hyrëse dhe pikën doganore dalëse.

Neni 9

Formatet për dhënien, shfuqizimin dhe pezullimin e licencave për prodhimin, importin/eksportin, si dhe të autorizimit të importit/eksportit dhe transitit të lëndëve plasëse për përdorim civil

1. Formatet e kërkesave për aplikim janë sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Formatet e licencave të prodhimit, importit eksportit, si dhe të autorizimit të importit/eksportit dhe transitit të lëndëve plasëse për përdorim civil janë sipas lidhjes 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Formatet e shfuqizimit dhe pezullimit të licencave dhe autorizimeve janë sipas lidhjes 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 10

Vlefshmëria e dokumentacionit

1. Dokumentacioni ligjor, i paraqitur nga operatorët ekonomikë për t'u pajisur me licencë ose autorizim prodhimi, importi ose eksporti të lëndëve plasëse për përdorim civil, i përcaktuar në nenet 5, 6, 7 dhe 8 të këtij vendimi, duhet të jetë lëshuar nga organet kompetente, brenda 3 (tre) muajve të fundit nga data e paraqitjes së kërkesës për pajisjen me licencë.

2. Për dokumentacionin, i cili lëshohet me afat të caktuar vlefshmërie, në funksion të licencës/autorizimit, operatori ekonomik ka detyrimin e rinovimit të tij, sipas legjislacionit në fuqi dhe paraqitjen e dokumentit të rinovuar, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

KREU III

PROCEDURAT E SHQYRTIMIT E TË VENDIMMARRJES DHE AFATET PËR KRYERJEN E TYRE

Neni 11

Procedura e shqyrtimit dhe vendimmarrjes për licencim

1. Operatori ekonomik aplikon nëpërmjet portalit *"e-Albania"* për t'u pajisur me autorizim për importin, eksportin, transitin e lëndëve plasëse dhe licencë të importit, eksportit ose prodhimit.

2. Dokumentacioni për individët, personat fizikë dhe juridikë, i cili do të sigurohet nga AKSHE-ja nëpërmjet ndërveprimit institucional, do të konsiderohet i vlefshëm dhe origjinal në dosjen e aplikimit dhe është, si më poshtë vijon:

a) Vërtetimi nga prokuroria e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kompetente në territorin ku ka selinë, që shoqëria dhe administratori nuk janë në procedim penal;

b) Vërtetimi që shoqëria dhe administratori nuk janë në proces gjyqësor penal, lëshuar nga gjykata e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kompetente në territorin ku ka selinë;

c) Vërtetimi nga Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror që shoqëria dhe administratori nuk kanë detyrime ndaj personave fizikë apo juridikë, privatë ose shtetërorë;

ç) Vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve ku subjekti ka selinë;

d) Vendimi për vlerësimin e ndikimit në mjedis, deklarata mjedisore dhe leja përkatëse mjedisore për prodhimin e lëndëve plasëse;

dh) Leja e ndërtimit të objektit për prodhimin e lëndëve plasëse;

e) Certifikata e Sigurisë nga Zjarri për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, për mjediset ku do të magazinohet dhe do të prodhohet lënda plasëse;

ë) Autorizimi për magazinimin e lëndëve plasëse, lëshuar nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë;

f) Certifikata e trajnimit për drejtuesin teknik për kryerjen e kursit të trajnimit "për aktivitete me rrezik të lartë zjarri" pranë Akademisë së Sigurisë, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin" ose nga qendra të tjera të certifikuara për sigurinë nga zjarri.

3. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, pas marrjes në shqyrtim të kërkesës nga operatori ekonomik, verifikimit të dokumentacionit, të përcaktuar në kreun II, dhe plotësimit të kushteve, të përcaktuara në kreun I të këtij vendimi, vendos miratimin, refuzimin apo i kërkon operatorit ekonomik të plotësojë mangësitë e konstatuara, nëpërmjet portalit *"e-Albania"*.

4. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve vendos refuzimin e kërkesës nëpërmjet portalit *"e-Albania"* për pajisje me licencë importi apo eksporti, në rastet kur:

a) administratori nuk gëzon besueshmërinë për ushtrimin e aktivitetit me lëndët plasëse, i provuar nëpërmjet vërtetimit të besueshmërisë, lëshuar nga struktura përgjegjëse në Policinë e Shtetit;

b) operatori ekonomik dhe administratori janë në proces gjyqësor penal;

c) operatori ekonomik dhe administratori janë të dënuar me vendim penal të formës së prerë.

5. Në rastet kur Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, gjatë shqyrtimit të dosjeve konstaton mangësi të dokumentacionit, të parashikuar në nenet 5, 6, 7 dhe 8 të këtij vendimi, nga ana e operatorit ekonomik, i kërkon atij nëpërmjet portalit *"e-Albania"* plotësimin e tyre. Operatori ekonomik ka 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kohë për të plotësuar mangësitë e konstatuara, në të kundërt kërkesa do të konsiderohet e refuzuar. Për këtë do të njoftohet elektronikisht me dokument, me vulë elektronike, nëpërmjet portalit *"e-Albania"* operatori ekonomik.

6. Në çdo rast, para lëshimit të licencës së prodhimit, si dhe gjatë vlefshmërisë së saj, kur konstatohen ndryshime, të cilat synojnë të prekin procesin teknologjik të prodhimit (makineri, objekte, produkt), Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve propozon, që me urdhër të ministrit përgjegjës për mbrojtjen, të caktohen ekspertë të fushës nga Forcat e Armatosura për verifikimin e kushteve dhe kritereve, të përcaktuara në këtë vendim.

Neni 12

Miratimi ose refuzimi i licencave

1. Miratimi ose refuzimi i licencave me vulë elektronike të importit dhe eksportit të lëndëve plasëse jepet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për pajisjen me licencë, nëpërmjet portalit *"e-Albania",* të shoqëruar me dokumentacionin e plotë.

2. Miratimi ose refuzimi i licencës së prodhimit të lëndëve plasëse jepet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për pajisjen me licencë, nëpërmjet portalit *"e-Albania"*, të shoqëruar me dokumentacionin e plotë.

Miratimi i testimit të lëndëve plasëse pezullon afatet e shqyrtimit të subjektit për licencën e prodhimit.

3. Miratimi ose refuzimi i autorizimeve për importin, eksportin, transitin e lëndëve plasëse jepet brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për pajisjen me autorizim, nëpërmjet portalit *"e-Albania",* të shoqëruar me dokumentacionin e plotë.

4. Për çdo ndryshim që mund të bëjë operatori ekonomik, pas marrjes së licencës, në elementet e veprimtarisë që kanë të bëjnë me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim, duhet të njoftojë, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve. Ndryshimet e kërkuara duhet të miratohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve me të njëjtën procedurë shqyrtimi, si ajo e miratimit të licencës. Në rast se ndryshimet e kërkuara nuk përputhen me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim, licenca apo autorizimi i lëshuar shfuqizohet.

KREU IV
AFATI I VLEFSHMËRISË SË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE DETYRIMET E OPERATORIT EKONOMIK

Neni 13
Afatet e licencimit dhe vlefshmërisë

1. Afati i vlefshmërisë së licencës për importin dhe eksportin e lëndëve plasëse është 5-vjeçar.

2. Afati i vlefshmërisë së licencës për prodhimin e lëndëve plasëse është 8-vjeçar.

3. Afati i vlefshmërisë së autorizimeve për importin, eksportin dhe transitin e lëndëve plasëse është 1-vjeçar.

Neni 14
Detyrimet e operatorit ekonomik

1. Operatori ekonomik, i pajisur me licencë importi ose eksporti, duhet që t'i dërgojë AKSHE-së, nëpërmjet portalit *"e-Albania",* deklaratën vjetore, të shoqëruar me një pasqyrë për sasinë në gjendje të lëndëve plasëse, brenda datës 15 janar të çdo viti.

2. Operatori ekonomik, i pajisur me licencë prodhimi, duhet të raportojë pranë AKSHE-së, për:

a) sasinë e mallit të prodhuar çdo fund muaji;

b) deklaratën vjetore, të shoqëruar me një pasqyrë për sasinë në gjendje të lëndëve plasëse, brenda datës 15 janar, të vitit pasardhës.

3. Operatori ekonomik i licencuar për prodhimin e lëndëve plasëse, gjatë ushtrimit të veprimtarisë duhet të përmbushë këto detyrime:

a) Informon për probleme që lidhen me veprimtarinë e prodhimit të lëndëve plasëse autoritetin licencues ose autoritetet e tjera shtetërore, që kanë kompetenca për kontrollin e kësaj veprimtarie;

b) Përmbush brenda afateve detyrat e lëna pas inspektimit nga autoriteti licencues dhe autoritetet shtetërore që kanë kompetenca për kontrollin e kësaj veprimtarie;

c) Harton dhe afishon në mënyrë të dukshme skemat për reagimin ndaj situatave emergjente dhe parashikon plane të veçanta për përballimin e tyre;

ç) Lajmëron autoritetin licencues nëpërmjet portalit *"e-Albania"* për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me drejtuesit teknikë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga zgjidhja e kontratës së punës dhe zëvendëson drejtuesin teknik, brenda një periudhe kohore prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh. Për marrjen në shqyrtim të këtij ndryshimi ndiqet e njëjta procedurë, si ajo e pajisjes me licencë të subjektit. Në rast se drejtuesi teknik nuk plotëson kushtet e përcaktuara në këtë vendim, licenca apo autorizimi i lëshuar shfuqizohet.

4. Operatori ekonomik i pajisur me autorizim për import, eksport ose transit, duhet që:

a) për çdo transferim të mallit të njoftojë 24 (njëzet e katër) orë përpara mbërritjes së mallit në Republikën e Shqipërisë ose dërgimit me anën e një vetëdeklarimi Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për sasinë që do të importojë, do të eksportojë ose do të transitojë;

b) t'i dërgojë, nëpërmjet portalit *"e-Albania"*, Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dokumentet e importit, eksportit ose transitit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e livrimit, të shoqëruara me deklaratat doganore.

KREU V
PROCEDURAT E SHFUQIZIMIT DHE PEZULLIMIT TË LICENCAVE DHE AUTORIZIMEVE

Neni 15
Procedura e shfuqizimit dhe pezullimit të licencave dhe autorizimeve

1. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve vendos marrjen e masave administrative me gjobë, me pezullim ose shfuqizim të licencës, apo autorizimit, sipas rasteve të përcaktuara në nenin 31, të ligjit nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse".

2. Përveç rasteve të përcaktuara në ligjin për lëndët plasëse për përdorim civil dhe në ligjin për licencat, autorizimet dhe lejet, licenca apo autorizimi për importin, eksportin, prodhimin apo transitin e lëndëve plasëse shfuqizohet edhe në rastet kur operatori ekonomik është në tejkalim, ka shkelur apo nuk përmbush më kriteret dhe kushtet e përcaktuara në kreun I të këtij vendimi.

3. Struktura përgjegjëse, në rastet kur gjatë verifikimit të veprimtarisë së operatorit ekonomik gjen shkelje të kushteve të përcaktuara në licencë apo autorizim, pezullon licencën apo autorizimin deri në verifikimin e rrethanave.

4. Në rastet e pezullimit të licencës apo autorizimit, operatorit ekonomik i lihet një afat 6-mujor për plotësimin e mangësive të konstatuara. Në përfundim të këtij afati, në rast të mosplotësimit të mangësive, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve vendos për shfuqizimin e licencës ose autorizimit.

5. Në rastet kur operatorit ekonomik nuk i miratohet nga organet përgjegjëse rinovimi i dokumenteve, të përcaktuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8 të këtij vendimi, të cilat lëshohen me afat të caktuar, licencat e prodhimit, importit ose eksportit të lëndëve plasëse për përdorim civil ose autorizimet përkatëse shfuqizohen. Për këtë, operatori ekonomik do të njoftohet elektronikisht, me dokument me vulë elektronike, nëpërmjet portalit *"e-Albania*".

6. Struktura përgjegjëse njofton për shfuqizimin e autorizimit me të njëjtat mënyra që është paraqitur kërkesa, duke nxjerrë një vendim të arsyetuar.

Neni 16
Ankimimi ndaj vendimeve të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve

Vendimet e AKSHE-së mund të ankimohen në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 17
Bashkëpunimi me institucionet e tjera

AKSHE-ja bashkëpunon me institucionet e tjera përgjegjëse, të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse", si dhe kërkon, pranon dhe u jep atyre zyrtarisht informacion për operatorët ekonomikë, që paraqesin kërkesat për pajisjet me licencë apo autorizim pranë tij, sipas fushave të përgjegjësisë.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 18
Dispozita kalimtare

Ofrimi i shërbimit nëpërmjet portalit *"e-Albania"* do të kryhet pas krijimit të infrastrukturës së nevojshme teknike. Deri në realizimin e saj, komunikimi i subjekteve me AKSHE-në dhe anasjelltas, në funksion të procedurave sipas këtij vendimi, do të kryhet nëpërmjet shërbimit postar.

Neni 19
Dispozita të fundit

1. Termat dhe përkufizimet e përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse", kanë të njëjtin kuptim dhe në këtë vendim.
2. Vendimi nr. 469, datë 29.6.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për procedurën për dhënien e lejes së importimit, eksportimit dhe prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil", të ndryshuar, shfuqizohet.
3. Licencat dhe autorizimet e dhëna publikohen në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.
4. Ngarkohen Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LIDHJA NR.1

<table>
<tr><td colspan="2">REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE
-A.K.SH.E -</td><td colspan="3">KËRKESË PËR LICENCË PRODHIMI PËR LËNDE PLASËSE</td></tr>
<tr><td rowspan="6">KËRKESË PËR LICENCË PRODHIMI PËR LËNDË PLASËSE</td><td colspan="2">1. Prodhuesi:

Adresa e aktivitetit:

Selia e shoqërisë:,

Tel:

NIPT :

Personi i kontaktit:</td><td colspan="2">2. Certifikata e konformitetit
Nr.:

3. Moduli sipas trupit të certifikuar:</td></tr>
<tr><td>4. Përshkrimi i produkteve</td><td>5. Kategoria</td><td colspan="2">6. Shkalla e rrezikshmërisë</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td colspan="4">7. Përfaqësuesi ligjor/Pika e kontaktit/Administratori</td></tr>
<tr><td colspan="4">8. Autorizoj Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve të verifikojë të dhënat e subjektit aplikues për:
• vërtetimin nga prokuroria që shoqëria dhe administratori nuk janë në procedim penal;
• vërtetimin që shoqëria dhe administratori nuk janë në proces gjyqësor penal, lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor që ka selinë;
• vërtetimin nga përmbarimi që shoqëria dhe administratori nuk kanë detyrime ndaj personave fizikë apo juridikë, privatë ose shtetërorë;
• vërtetimin nga dega e tatim-taksave për shlyerjen e detyrimeve;
• vendimin për vlerësimin e ndikimit në mjedis, deklaratë mjedisore dhe lejen përkatëse mjedisore për prodhimin e lëndëve plasëse;
• lejen e ndërtimit për prodhimin e lëndëve plasëse;</td></tr>
</table>

	• aktin teknik për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi, për mjediset ku do të magazinohet dhe prodhohet lënda plasëse; • autorizimin për magazinimin e lëndëve plasëse, lëshuar nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë; • certifikatën e trajnimit për drejtuesin teknik për kryerjen e kursit të trajnimit për zjarrfikës me rrezik të lartë pranë Akademisë së Sigurisë, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin.
	9.Informacion shtesë
	Deklaratë e kërkuesit: Deklaroj, nën përgjegjësinë time të plotë personale dhe ligjore, që informacionet dhe dokumentet e paraqitura janë të vërteta. Jam në dijeni se, çdo deklaratë e rremë në lidhje me të dhënat e mësipërme, mund të ndiqet ligjërisht dhe të dënohet nga legjislacioni shqiptar. Emër, mbiemër Pozicioni Firma Vula Data

REPUBLIKA E SHQIPËRISË **AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE** **-A.K.SH.E -**	KËRKESË PËR LICENCË PËR IMPORT / EKSPORT TË LËNDËVE PLASËSE

Subjekti _____

Adresa _____

Telefon _____

NIPT _____

Lloji i licencës së kërkuar:

Licencë importi ☐

Licencë eksporti ☐

në cilësinë e subjektit tregtar të përfshirë në veprimtari tregtare me LËNDË PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL, kërkoj lëshimin e licencës së eksportit _____/ importit _____ nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

Autorizoj Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve të verifikojë të dhënat e subjektit aplikues për:

- gjendjen gjyqësore (penal dhe civile) lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor, ku subjekti ka selinë.
- gjendjen e procedimit penal nga prokuroria.
- gjendjen mbi detyrimet ndaj personave fizikë apo juridikë, privatë apo shtetërorë nga përmbarimi.
- gjendjen e për shlyerjen e detyrimeve nga dega e tatim taksave.

Informacione shtesë:

Deklaratë e kërkuesit:
Deklaroj, nën përgjegjësinë time të plotë personale dhe ligjore, që informacionet dhe dokumentet e paraqitura janë të vërteta. Jam në dijeni se, çdo deklaratë e rremë në lidhje me të dhënat e mësipërme, mund të ndiqet ligjërisht dhe të dënohet nga legjislacioni shqiptar.

Emër, mbiemër _____

Pozicioni _____

Firma _____

Vula _____

Data _____

KËRKESË PËR AUTORIZIM TRANSITI NDËRKOMBËTAR TË LËNDËVE PLASËSE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE
-A.K.SH.E -

KËRKESË
PËR AUTORIZIM TRANSITI NDËRKOMBËTAR TË LËNDËVE PLASËSE

1. Subjekti aplikues Adresa Telefoni NIPT			4.Rrugët e transitit në territorin e Republikës së Shqipërisë			
			5. Dërguesi		6. Transportuesi ndërkombëtar	
			7. Shteti i origjinës	Kodi i shtetit	8. Shteti importues	Kodi i shtetit
2. Eksportuesi Adresa Telefoni NIPT			9. Shteti i destinacionit të	Kodi i shtetit	10. Vendet transit/transship	
			11. Mënyra e transportit		12. Mjetet e transportit	
			13. Përdoruesi i fundit		14. Qëllimi i përdorimit të fundit	
3. Importuesi Adresa Telefoni NIPT			15. Pika doganore hyrëse		16. Pika doganore dalëse	
			17. Data e hyrjes		18. Data e daljes	
19. Vlefshmëria e kërkuar						
20. Përshkrimi i mallrave	21. Kodi doganor i mallit	22. Kodi OKB	23. Sasia		24.Vlera në monedhën e pagesës	
			Njësia	Shifra		
25. Totali						
26. Administratori/ Përfaqësuesi ligjor						
27. Autorizoj Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve të verifikojë të dhënat e subjektit aplikues për: • Licencën e transportit për armët e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.						

Deklaratë e kërkuesit:
Deklaroj, nën përgjegjësinë time të plotë personale dhe ligjore, që informacionet dhe dokumentet e paraqitura janë të vërteta.
Jam në dijeni se, çdo deklaratë e rremë në lidhje me të dhënat e mësipërme, mund të ndiqet ligjërisht dhe të dënohet nga legjislacioni shqiptar.

Emër, mbiemër _____

Pozicioni _____

Firma _____

Vula _____

Data _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

KËRKESË PËR AUTORIZIM PËR IMPORT/EKSPORT TË LËNDËVE PLASËSE

KËRKESË PËR AUTORIZIM PËR IMPORT OSE EKSPORT TË LËNDËVE PLASËSE

1. Importuesi Adresa Tel: NIPT	2. Eksportuesi Adresa Tel: NIPT		3. Kontrata e shit-blerjes (Nr. / datë)		Lloji i autorizimit të kërkuar: **Autorizim importi** ☐ **Autorizim eksporti** ☐
			4.Shteti importues	Kodi	5. Vendet transit
			6. Mënyra e transportit		

7.Përshkrimi i mallrave	8. Kodi OKB	9.Klasa e rrezikshmërisë	10.Sasia		11. Vlera në monedhën e pagesës	
			Njësia	Shifra	Çmimi për njësi	Çmimi total

12. Totali	
13. Pika doganore	14. Përfaqësuesi ligjor/Pika e kontaktit/Administratori

15.Informacione shtesë

Deklaratë e kërkuesit:
Deklaroj, nën përgjegjësinë time të plotë personale dhe ligjore, që informacionet dhe dokumentet e paraqitura janë të vërteta.
Jam në dijeni se, çdo deklaratë e rremë në lidhje me të dhënat e mësipërme, mund të ndiqet ligjërisht dhe të dënohet nga legjislacioni shqiptar.

Emër, mbiemër _____

Pozicioni _____

Firma _____

Vula _____

Data _____

LIDHJA NR.2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

-A.K.SH.E -

LICENCË PRODHIMI PËR LËNDE PLASËSE

LICENCË PRODHIMI PËR LËNDË PLASËSE

1. Prodhuesi: Adresa e aktivitetit: Selia e shoqërisë:, Tel: NIPT :		2. Certifikata e konformitetit nr.: 3. Moduli sipas trupit të certifikuar:
4. Përshkrimi i produkteve	5. Kategoria	6. Shkalla e rrezikshmërisë
7. Përfaqësuesi ligjor/Pika e kontaktit/Administratori		
Lëshuar më datë:		E vlefshme deri më datë:

1. **BAZA LIGJORE**

Në zbatim të ligjit nr.74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse", VKM nr. _____, datë _____ "Për procedurat, kushtet, kriteret, afatet, vlefshmërinë dhe formatet për dhënien, shfuqizimin dhe pezullimin e licencave dhe autorizimeve për prodhimin, importimin, eksportimin, transitimin e lëndëve plasëse për përdorim civil".

2. Subjekti ka detyrimin për rinovimin e dokumentacionit të lëshuar me afat të përcaktuar dhe paraqitjen pranë AKSHE-së sa herë që mbaron afati i vlefshmërisë së dokumentacionit.

3. Prodhimi i lëndëve plasëse të bëhet duke mbrojtur sigurinë publike dhe duke zbatuar me korrektësi rregullat e sigurimit teknik, ligjet dhe udhëzimet në fuqi për prodhimin, përdorimin dhe punët me lëndët plasëse, nga subjekti "_____", sh.p.k., me adresë _____.

Subjekti prodhues duhet të zbatojë të gjitha detyrimet e përcaktuara në nr.74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse".

4. Subjekti ka detyrimin ligjor për të njoftuar AKSHE-në, brenda 10 ditëve pune, për çdo ndryshim në kushtet e përcaktuara në licencë.

5. Subjekti duhet të sigurohet që produktet e prodhuara të etiketohen në gjuhën zyrtare në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe që nuk fshihet. Etiketimi të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i thjeshtë.

6. Licenca hartohet në 3 (tri) kopje: një i jepet subjektit, një në dosjen e subjektit, një në zyrën e protokollit të AKSHE-së.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

LICENCË PRODHIMI Nr. Data:

VULA **KRYETARI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË **AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE** **-A.K.SH.E -**	**LICENCË PËR IMPORT TË LËNDËVE PLASËSE**

KJO LICENCË IMPORTI JEPET PËR

Subjekti …… _

Adresa ……

Telefon……..

NIPT……

NË CILËSINË E SUBJEKTIT TREGTAR TË PËRFSHIRË NË VEPRIMTARI TREGTARE IMPORTI TË LËNDËVE PLASËSE,

Lëshuar më datë	E vlefshme deri më

7. **BAZA LIGJORE**

   Në zbatim të ligjit nr.74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse", VKM-së nr. _____, datë _____, "Për procedurat, kushtet, kriteret, afatet, vlefshmërinë dhe formatet për dhënien, shfuqizimin dhe pezullimin e licencave dhe autorizimeve për prodhimin, importimin, eksportimin, transitimin e lëndëve plasëse për përdorim civil".

8. Subjekti ka detyrimin për rinovimin e dokumentacionit të lëshuar me afat të përcaktuar dhe paraqitjen pranë AKSHE-së sa herë që mbaron afati i vlefshmërisë së dokumentacionit.

9. Importi i lëndëve plasëse të bëhet duke mbrojtur sigurinë publike dhe duke zbatuar me korrektësi rregullat e sigurimit teknik, ligjet dhe udhëzimet në fuqi për prodhimin, përdorimin dhe punët me lëndët plasëse, nga subjekti "_____", sh.p.k., me adresë _____.

   Subjekti importues duhet të zbatojë të gjitha detyrimet e përcaktuara në ligjin nr.74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse".

10. Subjekti ka detyrimin ligjor për të njoftuar AKSHE-në, brenda 10 ditëve pune, për çdo ndryshim në kushtet e përcaktuara në licencë.

11. Subjekti duhet të sigurohet që produktet e importuara të etiketohen në gjuhën zyrtare në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe që nuk fshihet. Etiketimi të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i thjeshtë.

12. Licenca hartohet në 3 (tri) kopje: një i jepet subjektit, një në dosjen e subjektit, një në zyrën e protokollit të AKSHE-së.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

LICENCË IMPORT Nr. Data:

VULA **KRYETARI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË **AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE** **-A.K.SH.E -**	**LICENCË PËR EKSPORT TË LËNDËVE PLASËSE**

KJO LICENCË EKSPORTI JEPET PËR

Subjekti …… _____

Adresa ……

Telefon……..

NIPT……

NË CILËSINË E SUBJEKTIT TREGTAR TË PËRFSHIRË NË VEPRIMTARI TREGTARE EKSPORTI TË LËNDËVE PLASËSE,

Lëshuar më datë;	E vlefshme deri më;

13. **BAZA LIGJORE**

    Në zbatim të ligjit nr.74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse", VKM-së nr. _____, datë _____, "Për procedurat, kushtet, kriteret, afatet, vlefshmërinë dhe formatet për dhënien, shfuqizimin dhe pezullimin e licencave dhe autorizimeve për prodhimin, importimin, eksportimin, transitimin e lëndëve plasëse për përdorim civil".

14. Subjekti ka detyrimin për rinovimin e dokumentacionit të lëshuar me afat të përcaktuar dhe paraqitjen pranë AKSHE-së sa herë që mbaron afati i vlefshmërisë së dokumentacionit.

15. Importi i lëndëve plasëse të bëhet duke mbrojtur sigurinë publike dhe duke zbatuar me korrektësi rregullat e sigurimit teknik, ligjet dhe udhëzimet në fuqi për prodhimin, përdorimin dhe punët me lëndët plasëse, nga subjekti "_____", sh.p.k., me adresë _____.

    Subjekti eksportues duhet të zbatojë të gjitha detyrimet e përcaktuara në ligjin nr.74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse".

16. Subjekti ka detyrimin ligjor për të njoftuar AKSHE-në, brenda 10 ditëve pune, për çdo ndryshim në kushtet e përcaktuara në licencë.

17. Subjekti duhet të sigurohet që produktet e eksportuara të etiketohen në gjuhën zyrtare në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe që nuk fshihet. Etiketimi të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i thjeshtë.

18. Licenca hartohet në 3(tre) kopje: një i jepet subjektit, një në dosjen e subjektit, një në zyrën e protokollit të AKSHE-së.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

LICENCË IMPORT Nr. Data:

VULA **KRYETARI**

AUTORIZIM PËR IMPORT TË LËNDËVE PLASËSE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE
-A.K.SH.E -

AUTORIZIM PËR IMPORT PËR LËNDË PLASËSE

1. Importuesi Adresa Tel: NIPT	2. Eksportuesi Adresa Tel: NIPT		3. Kontrata e shitblerjes (Nr. / date.)			
			4.Shteti importues	Kodi	5. Vendet transit	
			6. Mënyra e transportit			

7.Përshkrimi i mallrave	8. Kodi OKB	9.Klasa e rrezikshmërisë	10.Sasia		11. Vlera në monedhën e pagesës	
			Njësia	Shifra	Çmimi për njësi	Çmimi total

12. Totali	
13. Pika doganore	14. Përfaqësuesi ligjor/Pika e kontaktit/Administratori

BAZA LIGJORE

Në zbatim të ligjit nr.74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse", VKM-së nr. _____, datë _____, "Për procedurat, kushtet, kriteret, afatet, vlefshmërinë dhe formatet për dhënien, shfuqizimin dhe pezullimin e licencave dhe autorizimeve për prodhimin, importimin, eksportimin, transitimin e lëndëve plasëse për përdorim civil".

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

AUTORIZIM IMPORTI Nr. Data:
AFATI I VLEFSHMËRISË : Data:

VULA **KRYETARI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE
-A.K.SH.E -

AUTORIZIM PËR EKSPORT PËR LËNDË PLASËSE

AUTORIZIM PËR EKSPORT TË LËNDËVE PLASËSE

1. Importuesi Adresa Tel: NIPT	2. Eksportuesi Adresa Tel: NIPT		3. Kontrata e shitblerjes (Nr. / datë) 4.Shteti Importues	Kodi	5. Vendet transit 6. Mënyra e transportit		
7.Përshkrimi i mallrave	8. Kodi OKB	9.Klasa e rrezikshmërisë	10.Sasia		11. Vlera në monedhën e pagesës		
			Njësia	Shifra	Çmimi për njësi	Çmimi total	
12. Totali							
13. Pika Doganore			14. Përfaqësuesi ligjor/Pika e kontaktit/Administratori				

BAZA LIGJORE

Në zbatim të ligjit nr.74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse", VKM-së nr. _____, datë _____ , "Për procedurat, kushtet, kriteret, afatet, vlefshmërinë dhe formatet për dhënien, shfuqizimin dhe pezullimin e licencave dhe autorizimeve për prodhimin, importimin, eksportimin, transitimin e lëndëve plasëse për përdorim civil.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

AUTORIZIM EKSPORTI Nr. Data:

AFATI I VLEFSHMËRISË : Data:

VULA **KRYETARI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

-A.K.SH.E -

AUTORIZM TRANSITI NDËRKOMBËTAR TË LËNDËVE PLASËSE

AUTORIZIM TRANSITI NDËRKOMBËTAR TË LËNDËVE PLASËSE

1. Subjekti aplikues Adresa Telefoni NIPT			4.Rrugët e transitit në territorin e Republikës së Shqipërisë			
			5. Dërguesi		6. Transportuesi ndërkombëtar	
			7. Shteti i origjinës	Kodi i shtetit	8. Shteti importues	Kodi i shtetit
2. Eksportuesi Adresa Telefoni NIPT			9. Shteti i destinacionit të	Kodi i shtetit	10. Vendet transit/transship	
			11. Mënyra e transportit		12. Mjetet e transportit	
			13. Përdoruesi i fundit		14. Qëllimi i përdorimit të fundit	
3. Importuesi Adresa Telefoni NIPT			15. Pika doganore hyrëse		16. Pika doganore dalëse	
			17. Data e hyrjes		18. Data e daljes	
19. Përshkrimi i mallrave	20. Kodi Doganor i mallit	21. Kodi OKB	22. Sasia		23.Vlera në monedhën e pagesës	
			Njësia	Shifra		
24. Totali						

BAZA LIGJORE

Në zbatim të ligjit nr.74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse", VKM-së nr. _____, datë _____, "Për procedurat, kushtet, kriteret, afatet, vlefshmërinë dhe formatet për dhënien, shfuqizimin dhe pezullimin e licencave dhe autorizimeve për prodhimin, importimin, eksportimin, transitimin e lëndëve plasëse për përdorim civil".

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

AUTORIZIM TRANSITI Nr. Data:

AFATI I VLEFSHMËRISË : Data:

VULA **KRYETARI**

LIDHJA NR.3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

VENDIMI Nr.____ datë ___/___/___
PËR SHUQIZIMIN / PEZULLIMIN E LICENCËS / AUTORIZIMIT

Në zbatim të ligjit nr.74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil", Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve;

SHFUQIZON ☐

PEZULLON ☐

Licencë / Autorizimi nr._____, datë _____ , të subjektit _____, me administrator z._____ dhe drejtues teknik z. _____, me seli në_____, me adresë të aktivitetit_____, pasi pas verifikimeve të kryera nga struktura ky institucion u konstatua se subjekti:

(*arsyetimi i vendimit të shfuqizimit apo pezullimit*)

_____

_____

Kundër këtij vendimi të Autoritetit i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve mund të ankimohet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

KRYETARI

_____